



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 4
14.01.2014

NR. VENDIMI 2
16.01.2014

V E N D I M
per
“SEKUESTRIMIN E PASURISE “

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

Gjyqtar : Nertina KOSOVA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Blerina Sukaj** sot, ditën e enjte, më dt.**16.01.2014, ora 13.30**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqësore jo publike kerkesen penale nr.4 me:

KERKUES: Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda - Tirane, Perfaqesuar nga Prokurori Ened Nakuçi.

KUNDER:Shtetasve nen hetim: **-R.F.**, i biri i V. dhe i N., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

-R.F., i biri i R. dhe i Xh., i datëlindjes xxx lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

-K.(B.) B.(F.) i i R. dhe i Xh., i datëlindjes xxx lindur dhe banues në fshatin xxx, bashkia xxx, xxx.

OBJEKTI: “Sekuestrim pasurie”

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të prokurorit Ened Nakuci që kërkoi pranimin e kërkesës së konkretisht :

I- Sekuestrimin e shumave në depozitën e kursimit me gjendje xxx lekë në bankën "xxx" që i përkasin shtetas Xh. dhe I.F.

-Sekuestrimin e depozitës bankare e gjendur në xxx bank, në shumën xxx lekë në emër të shtetasit R.V.F. ndaj së cilës është vendosur sekuestro preventive.

II. Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme si më poshtë vijon :

- **Pasuria** me nr.xxx/x, zk xxxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.
- **Pasuria** me nr.xxx/x, vol.x, fq.xxx me sipërfaqe xxxx m², ZK xxxx, xxxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, blerë në shumën xxx lekë nga G.B.
- **Pasuria** me nr. xxx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.x, me sipërfaqe xxxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj.Gj.
- **Pasuria** me nr.xxx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.xx, are me sipërfaqe xxxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.
- **Pasuria** me nr.xx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, përfituar me kontratë këmbimi.
- **Pasuria** me nr.xx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m², në pronësi të Xh.F., regjistruar në xxx xxx, blerë në shumën xxx lek.
- **Pronës së paluajtshme të** me nr.xxx/x, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xxxx m², xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxxx (për të cilën në datën xxx vendoset është vendosur **Sekuestro Preventive** nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx).

III- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme të ngarkohet zj.E.Ç., e cila është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

IV. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

Gjykata si mori në shqyrtim aktet e provat e paraqitura;

VËREN SE:

Me date xxx ne sekretarine e kesaj Gjykate është depozituar per gjykim kërkesa penale e Prokurorisë prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me objektin lartpërmendur mbi procedimin pasuror nr x date xxx.

Rezulton se Prokuroria per Krime te Renda Tirane ne funksion te procedimit penal nr. xx te regjistruar me date xxx, ceshtje e cila eshte ne hetim prane Prokurorise se xxx, mbi bazën e materialit të referuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Sektorit të Hetimit të Aseteve Kriminale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut xxx në dt. xxx, si të dyshuar, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” në ngarkim të shtetasve R.F., R.F.

Nga hetimi e aktet e Prokurorisë, ka rezultuar nder te tjera se për shtetasit **R.F., R.F., K.(B.) B.(F.)**, janë identifikuar pasuri të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se rrjedhin nga veprimtaria kriminale e shtetasve K.F. i cili rezulton se është i dënuar në shtetin italian për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”. Në bazë të materialeve të dërguara nga Drejtoria e Policisë xxx me relacionin Nr.xxx dt xxx, pas regjistrimit te ceshtjes per vepren penale të “Mashttrimit” e ”Pastrimit te produkteve te vepres penale” parashikuar nga nenet 143/2 e 287 të Kodit penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, me pas ka vijuar procedura per regjistrimin e procedimit pasuror nga Prokuroria per Krime te Renda Tiranë, Nr.x date xxx.

Akuza argumenton se shtetasit R.F., R.F. dhe familjarët e tyre janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sipas nenit 3/1 pika ‘d’, pasi shtetasi R.F., R.F. hetohen nga ana Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx për veprën penale të “Mashttrimit” dhe **“Pastrimit të produkteve të veprës penale”**, parashikuar nga nenet 143 e **287 te K.Penal**, ndërsa shtetasi K.(B.) B.(F.) i cili është dënuar në shtetin xxx për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, vepër kjo që parashikohet dhe nga kodi penal shqiptar në nenin 283/a/2 të tij, është subjekt i hetimit pasuror në bazë të nenit 3/1 pika ‘ç’ të ligjit të mësipërm, duke paraqitur dhe veprimet e kryera per verifikimin e pasurive e te dhenave.

Mbi kete baze, provohet se ne date xxx, Prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr. xx në ngarkim të shtetasve **R.F.,R.F.,K.(B.) B.(F.)**, ne perputhje me parashikimin e nenit 3/1/ ‘d’;’ç’ te ligjit 10192 sepse jane dënuar(K.(B.) B.(F.)) për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” si dhe janë duke u gjykuar shtetasit R. e R.F. për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Pra nga prokuroria pretendohet se të hetuarit **R.F., R.F., K.(B.) B.(F.)**, ne

baze te nenit 3/1 germa “d”e ”ç” janë dhe subjekte të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Rezulton se për këta shtetas Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar sekuestrimin e disa pasurive të luajtshme sikunder jane vlera monetare e pasqyruar ne llogarite perkatese me gjendje **xxx lekë në bankën “xxx” që i përkasin shtetases Xh.I.F.**

- *-Sekuestrimin e depozitës bankare e gjendur ne Raiffeisen bank, në shumën **xxx lekë** në emër të shtetasit R.V.F. (ndaj së cilës është vendosur sekuestro preventive) si dhe disa pasuri te paluajtshme sikunder janë: **Pasuria** me nr.xxx/x,zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.*
- ***Pasuria** me nr.xxx/x, vol.x, fq.xxx me sipërfaqe xxx m2, ZK xxx, xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, blerë në shumën xxx lekë nga G.B.*
- ***Pasuria** me nr. xxx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.x, me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj.Gj.*
- ***Pasuria** me nr nr.xxx/xx,zk xxxx, vol.x, fq.xx, are me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.*
- ***Pasuria** me nr.xx/xx, zk xxxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, përfituar me kontratë këmbimi.*
- ***Pasuria** me nr.xx/xx ,zk xxxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxxx m2, në pronësi të Xh.F., regjistruar në xxx xxx, blerë në shumën xxx lek.*
- ***Pronës së paluajtshme të me nr.xxx/x, vol.x, fq.x me sipërfaqe xxxx m², xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxxx (për të cilën në datën xxx është vendosur **Sekuestro Preventive** nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx).***

Sipas palës kërkuese/prokurorit dhe akteve ndodhur ne fashikull, per nje pjesë të ketyre shumave monetare te *depozitës bankare e gjendur ne xxx Bank, në shumën **xxx lekë** në emër të shtetasit R.V.F., eshte vendosur sekuestro preventive ne funksion te procedimit penal nr xx/xxxx të Prokurorisë së Rrethit Durrës si dhe **Pronës së paluajtshme të me nr.xxx/x, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xxxx m², xxxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxxx, për të cilën gjithashtu në datën xxx është vendosur **Sekuestro Preventive me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, me vendimin nr.xxx/x datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx janë vënë në sekuestro preventive.*****

Prokurori pretendon se te hetuarit R. e R.F., bazuar dhe ne nenin 3/1/d të Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, janë subjekte të ketij ligji mbështetur në nenin 287 të K.Penal, ndaj dhe pasuritë e evidentuara se jane ne disponim

të tyre, duhet që ti nënshtrohen procedurës së sekuestrimit sipas ligjit të mesiperm, ndërsa shtetasi K.(B.) B.(F.) është konform nenit 3/1/ ”ç” të Ligjit 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Prokurori pretendon se ndaj të hetuarve për këto procedim pasuror, nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rrënda të Tiranës në kushtet kur janë gjetur elementët e që përmbushin kriteret e ligjit të posaçëm 10192, si dhe mbi faktin se shtetasi K.F. është gjykuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikeve” në bashkëpunim, sipas nenit 283/a/2 të K.P., si dhe janë duke u hetuar shtetasit R. e R.F., ndër të tjera dhe për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 të K.Penal, ndaj nuk ka pengesë për të vijuar hetimi pasuror dhe për të marrë masa parandaluese kundër pasurisë së tyre.

Për më tepër prokurori pretendon e argumenton se ekziston rreziku real dhe potencial që pasuritë e mesipërme të tjetërsohen, apo të humbasin, prandaj në bazë të nenit 11/1 të ligjit të sipercituar ato duhet të sekuestrohen në përputhje me nenin 3/1 germa të “d” e “ç” të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Nga prokurori janë kryer verifikimet pasurore për shtetasit R.F., Xh.F., A.F., B.F., K.F., R.F., E.F. e për të provuar pretendimet e tij përfaqësuesi i akuzës paraqiti për shqyrtim këto prova shkresore:

- *Urdhër i datës xxx, për regjistrimin e procedimit pasuror,*
- *Relacion i oficerit të policisë gjyqësore M.K. datë xxx.*
- *Shkresa Nr.xxxx/x dt xxx me anë të së cilës është vënë në dispozicion dispozicion dosja hetimore e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, Nr xx viti xxxx.*
- *Shkresa nr. xxxxx, dt xxx, ka vënë në dispozicion dosjen aktin e ekspertimit kontabël të kryer në kuadrin e këtij procedimi.*
- *Shkresa nr.xxx dt xxx e Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxx, Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale së bashku me materialin referues dhe certifikata familjare dhe personale.*
- *Shkresa nr.xxx datë xxx e Zyrës së Gjendjes Civile xxx së bashku me dhjetë certifikata.*
- *Z.V.R.P.P xxx me shkresën nr.prot.xxxx/x datë xxx;*
- *Përgjigje nga Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve, me shkresën nr.xx/x datë xxx*
- *Përgjigje nga Drejtoria e përgjithshme të Doganave, me shkresën nr.xxxx/x datë xxx,*
- *I është dërguar shkresa me nr.prot. xxxx datë xxx nga Zyra kombëtare e punësimit;*
- *Shkresa nga ana e kompanisë « C.E.Z » me nr.prot.xxxxx/x datë xxx*
- *Përgjigja nga ana e Qendrës Kombëtare e regjistrimit me nr.prot.xxxxx/x datë xxx .*
- *Përgjigje nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr.prot.xxxxx datë xxx*
- *Përgjigje nga ana e ALUIZNIT me shkresën nr.xxxx/x datë xxx;*
- *Përgjigje nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr.prot.xxxxx/x datë xxx;*
- *-Përgjigjet e ardhura nga bankat të cilat veprojnë në territorin e shtetit Shqiptar, përkatësisht :*

- Banka xxx me shkresën nr.prot.xxx datë xxx.
- Banka « xxx » me shkresën nr.xxx datë xxx ;
- Banka « xxx » me shkresën nr.prot.xxx datë xxx ;
- Banka « xxx » me shkresën me nr.prot. xxx datë xxx ;
- Banka « xxx » me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx ;
- Në bankën « xxx » me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx ;
- Në bankën « xxx » me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx ;
- Në bankën xxx », me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx rezulton se asnjë prej klientëve të mësipërm nuk ka llogari pranë kësaj banke.
- Në bankën « xxx » me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx ;
- Në bankën « xxx », me shkresën me nr.prot.xxx datë xxx ;
- Në bankën « xxx » me shkresën me nr.prot.xxx, datë xxx ;
- Në bankën xxx në shkresën me nr.prot xxx datë xxx ;
- Në bankën « xxx », me shkresën me nr.prot xxx datë xxx ;
- Akti i ekspertimit kontabël, datë xxx, i ekspertës Zj. A.K.;
- Aktet e fashikullit hetimor të procedimit penal nr.xx të vitit xxx të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx në ngarkim të shtetasve R.F. dhe R.F.;

Nga Gjykata cmohet se kjo kerkese eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova e si e tille duhet te pranohet.

Gjykata si degjoi pretendimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e mesiperme konkludon se, ne baze te nenit 3/1/'d''e ''ç'' te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", të hetuarit në këtë procedim pasurorjanë subjekte të ligjit parandalues sepse per ta ka dyshime te arsyeshme te mbeshtetura ne prova se kanë konsumuar elemente te veprës penale te "Trafikimit te narkotikeve" ne bashkepunim, (shtetasi K.F.), parashikuar nga neni 283/a/2 te K.Penal si dhe ndaj shtetasve R. e R.F. dyshohet se janë konsumuar elemente të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të krimin" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Provohet se në bazën e materialit referues nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Sektorit të Hetimit të Aseteve Kriminale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut xxx në dt. xxx Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr.xx për veprën penale të "Mashtimit" e "Pastrimit të produkteve të veprës penale" në ngarkim të shtetasve R.F., R.F. e rezulton se për këta shtetas jane identifikuar pasuritë të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se rrjedhin nga veprimtaria kriminale e shtetasve K.F. i cili rezulton të jetë dënuar në shtetin xxx për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" e sa i përket pasurive të disponuara prej tyre e familjarëve te tij figurojnë:

1. Pikë për përpunimin e inerteve të ndryshme me sipërfaqe xxx m2. Kjo pikë gjëndet në fshatin xxx, në krahun e majtë të rrugës xxx-xxx.
2. Kompleks shërbimesh, restorant për dasma, bar-kafe-pishina, 2 vila

banimi me sipërfaqe xxxm². Ky kompleks ndodhet në fshatin xxx, në krahun e majtë të rrugës xxx-xxx.

3. Sipërfaqe toke rreth xxx m². Kjo sipërfaqe toke gjëndet në afërsi të bregut të detit në fshatin xxx. etj

Sipas akteve të procedimit penal nr.xxx, ndodhur në fashikull, rezulton se nga zyra e Interpol Tirana, se shtetasi K.F. (i cili mban aktualisht mbiemrin B.), njihet si person me aktivitet kriminal ne fushen e lendeve narkotike ne disa raste dhe konkretisht, eshte denuar ne date xxx nga Gjykata e xxx xxx me x vjet burgim.

- Ky shtetas është daktiloskopuar ne date xxx ne lidhje me hetimin e projektit xxx Grup. Ky shtetas njihet gjithashtu me emrin B.F., N. ose A. lindur ne date xxx ne xxx.
- Ne date xxx shtetasi K.F. eshte arrestuar nga xxx xxx. Ai eshte pjese e informacionit te xxx ne operacionin xxx procedimi penal nr xxx/xxx xxx per krime te cilat jane te denueshme nga ligji per lendet narkotike.
- Ky shtetas eshte arrestuar se bashku me persona te tjere ne ekzekutim te urdher arrestit nr xxx xxx xxx xxx, leshuar nga xxx e Gjykates xxx xxx e dates xxx ne lidhje me operacionin xxx xxx zhvilluar nga autoritetet policore ne xxx xxx per shkelje te ligjit mbi drogat.
- Sipas të dhënave të administruara rezulton se shtetasi K.F. (i cili aktualisht mban mbiemrin B.) ka dy hetime te hapura dhe me konkretisht hetimi aktiv i autoriteteve te xxx me numer xxx i grupit xxx per trafik droge dhe perdorim mjetesh te vjedhura dhe hetim aktiv numer xxx, i grupit xxx per pjesemarrje ne organizate kriminale, trafik droge, e falsifikim dokumentash.

-Nga leterporosia e mberritur me shkresen nr reference xxx xx te Ministrise se Drejtesise se xxx rezulton se me vendimin e Gjykates se xxx date xxx shtetasi K.F.(B.) eshte shpallur fajtor per krimin “trafikim të narkotikeve“ se bashku me shtetasit E.D. dhe M.S.

Me vendimin e dates xxx te gjykates se Apelit te xxx eshte deklaruar se nuk duhet proceduar kunder M.S. per shkak te vdekjes se fajtorit, vendimi konfirmohet per pjesen tjeter. Nga vendimi i mesiperme gjyqesor rezulton se **hetimet ne lidhje me aktivitetin kriminal kane filluar qe ne xxx te vitit xxx nga skuadra e Anti krim e xxx te xxx, pas delegimit te Drejtorise se Rrethit Antimafia te prokurorise se Republikes se xxx.**

Pra rezulton e provuar se ndaj ketyre personave eshte regjistruar procedimi penal Nr xx /xxxx nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë në kushtet kur është paraqitur kërkesë me objektin lartpërmendur, Gjykata bazuar ne nenin 5 te ligjit parandalues vlereson se kerkesa e prokurorit dhe procedura e sekuestrimit te pasurive sipas ligjit parandalues, nuk varen nga gjendja e shkalla e procedimit penal.

Gjykata vlerëson, gjithashtu, se bazuar në ligjin 10 192 datë 03.12.2009, masat parandaluese ndaj pasurisë së të hetuarve, për përfshirjen në veprimtarinë e mësipërme kriminale, duhet te vendosen pavaresisht faktit se me pare per keto

shuma monetare e pasuri të paluajtshme, është vendosur sekuestro ne funksion te procedimit penal, meqenese per keto shuma monetare ekziston një rrezik real dhe potencial që pasuria e luajtshme, shumat monetare apo pronat e paluajtshme lartpërmendur te tjetërsohen, apo te humbasë (neni 11/1, pikat “a”e “b”), ne rast te shfuqizimit te sekuestros vendosur ne funksion te procedimit penal e bazuar në nenet; 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” si e tille kjo kerkesë duhet te pranohet.

Sipas shkresave ndodhur ne fashikull e deklarimit te Prokurorise Per Krime te Renda Tirane,rezulton se pranë Bankes xxx, shtetasi R.F. ka nje depozite rezulton se ndaj kesaj llogarie/depozite me afat deri ne xxx. me nr llogarie xxx si dhe te nje pasurie të paluajtshme, me pasurie xxx e gjendur ne zonen kadastrale xxx ne sipërfaqe xxx m(2) është vendosur sekuestro preventive mbi bazen e vendimit Nr xxx date xxx te Gjykates së Rrethit Gjyqësor xxx.

Nga ana e prokurorise per Krime te Renda, është marre Vendimi ‘Per regjistrimin e procedimit pasuror’ me date xxx është konsideruar qe te vijojë hetimi pasuror mbi llogarite bankare e pasurite e paluajtshme e te luajtshme qe mund te disponohen prej ketyre shtetasve per shkaqet ligjore te bazuara ne ligjin nr 10192 date 03.12.2009.

Pra sa me lart, Gjykata, bindet në ekzistencën e provave dhe të indicjeve për përfshirjen e të paditurve/hetuarve R. e R.F. në veprimtari kriminale të asaj natyre që ligji parandalues mund të veprojë sepse nga aktet e fashikullit të gjykimit e provat e paraqitura nga akuza, provohet se në kuadër të këtij procedimi penal për hetimin e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 të K.Penal e si shtetas i dënuar shtetasi K.(B.) B.(F.) për veprën penale të“Trafikimit të narkotikeve” ne bashkepunim sipas nenit 283/a/2 të K.Penale, mbeshtetur dhe ne kerkesen per gjykim se ndaj ketyre shtetasve ekziston nje dyshim i arsyeshem bazuar ne indicie te mjaftueshme, si dhe ne kushtet kur vepra per te cilen dy prej ketyre shtetasve. janë nën hetim përfshihet në listën e veprave penale për të cilat vepron ligji parandalues sipas nenit 3 të tij ne keto kushte Gjykata vlereson si te drejte dhe te bazuar ne ligj kerkesen e Prokurorise per Krime te

Renda Tirane. Sipas nenit 3 te ketij ligji parashikohet shprehimishte se:

1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.

d) kryerjen e krimeve per qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, te

parashikuara në nenet 11/a dhe 287 të Kodit Penal''

Ne baze te provave te marra e shqyrtuara ne seance gjyqesore, gjykata vlereson se kerkesa e akuzes per sekuestrimin paraprak te pasurive te evidentuara prej ketij organi ne pronesi te te hetuarve R.F., R.F. e K.(B.) B.(F.) eshte e drejte e duhet te pranohet.

Në dosjen hetimore të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, duke vene ne dispozicion pjeserisht dosjen hetimore Nr xx viti xxx si dhe me shkresen Nr. xx, dt xxx, ka vene ne dispozicion dosjen aktin e ekspertimit kontabël të kryer në kuadrin e këtij procedimi, që ndodhet ne fashikull.

Pas dergimit nga Prokuroria per Krime të Rënda Tiranë, të shkresave drejtuar **Zyrës Kombëtare të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Qendrore dhe atyre në nivel lokal** për pasuritë që zotërojnë shtetasit e mësipërm, rezulton se vetëm në Z.V.R.P.P xxx me shkresën nr.prot xxx/x datë xxx janë regjistruar pasuritë si më poshtë vijon :

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx/x.vol.x, fq.xx, fituar me AMTP xx,zk xx xxx, lloji i pasurisë arrë, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx xxx, me sipërfaqe xxx m2.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx/x, zk xxx, vol.x, fq.xx, fituar me AMTP xx, me sipërfaqe xxx m2, xxx, lloji i pasurisë arrë, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx xxx.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx/x, ZK xxx, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xx m2, fituar me AMTP xx, xxx, lloji i pasurisë arrë, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx xxx.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx/xx, ZK xx, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xxx m2, fituar me AMTP xx, xxx, lloji i pasurisë arrë, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx xxx.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx/x, ZK xxx, vol.x, fq.x, me sipërfaqe xxx m2, fituar me AMTP xx, xxx, lloji i pasurisë arrë, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx xxx.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx/x,zk xxx, vol.x, fq.xxx me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx/x, vol.x, fq.xxx me sipërfaqe xxx m2, ZK xxx, xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, blerë në shumën xxx lekë nga G.B.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx/xx, zk xxx, vol.x, fq.x, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj.Gj.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx/xx,zk xxx, vol.x, fq.xx, are me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj.P., F., A. dhe V.Gj.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx,zk xx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, përfituar me kontratë këmbimi.

- Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx ,zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të Xh.F., regjistruar në xxx xxx, blerë në shumën xxx lek.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx, zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F. dhe S.F., regjistruar në xxx, xxx, përfituar me kontratë dhurimi dt xxx.

-Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xxx m2, xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në vitin xxx. (mbi këtë pronë në datën xxx është vendosur *Sekuestro preventive* nga Prokuroria xxx.

- Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xx ,zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.F., përfituar me ndarje pasurie. (në datën xxx vihet në favor të xxx)

- Në **Z.V.R.P.P xxx** janë regjistruar pasuritë me nr.xxx ,zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.F., përfituar me ndarje pasurie. (në datën xxx vihet në favor të Banka xxx) ;

Gjithashtu janë kryer verifikime dhe nëpërmjet shkresave drejtuar Drejtorisë së përgjithshme të Doganave ; Zyrës kombëtare të punësimit ; kompanisë « C.E.Z » ; Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(Q.K.R) ; Institutit të Sigurimeve Shoqërore ; ALUIZNIT, nëse personat e mësipërm apo familjarët e tyre, kanë aplikuar për të legalizuar ndonjë pasuri të paluajtshme dhe nëse po të dërgohet cdo informacion që lidhet më këtë pronë prej nga rezulton me shkresën nr.xxx datë xxx se shtetasi :

-A.F., ka aplikuar për legalizim në zonën xxx-xxx, për një banesë ndërtuar në vitin xxx, me sipërfaqe xxx m2 dhe sip.trualli xxx m2.

Gjithashtu mbi aktivitetin e tyre që ka figuruar dhe pergjigjet e Q.K.R,

është marrë informacion dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbi aktivitetin tatimor të tyre; është verifikuar gjithashtu dhe mbi llogaritë

bankare duke u kerkuar e marre informacion nga të gjitha bankat në Republikën e Shqipërisë, nga përgjigjet e ardhura rezulton se në banken xxx në shkresën me nr.prot xxx datë xxx, rezulton se ndërmjet të tjerave:

-Shtetasi R.F. ka llogari, në lekë me gjendje xxx lekë.

-Depozita bankare e gjendur ne “xxx Bank” në shumën xxx lekë në emër të shtetasit R.V.F. me numër llogarie xxx ndaj së cilës është vendosur sekuestro preventive.

Ndërkohë për llogarine me gjendje xxx lekë në bankën “xxx” që i përkasin shtetases Xh.I.F. e pasurite e tjera të paluajtshme pasqyruar ne kerkesë nga kërkuesi kërkohet të vendoset sipas objektit të kerkimit duke vendosur dhe mbi to sekuestro.

Sipas kërkuesit/paditësit, Prokuroria për Krime të Rënda, nga verifikimet paraprake për shtetasit R.F., R.F. dhe K. (B.) B. (F.) nuk provohet të kenë patur aktivitetet ekonomik të tillë që të justifikojnë fitimin e pasurivë të mësipërme.

Ne baze të nenit 11/1/a të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” që parashikon se “ *Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:*

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji;

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.”

Gjykata, nisur edhe nga vlera e numri i pasurive, mbi bazen e provave të shqyrtuara, vlereson se ekziston rreziku real për tjetërsimin e këtyre pasurive që kërkohen të sekuestrohen, që disponohen në emër të hetuarit/paditurve apo të aferm të tyre, rrethane kjo e parashikuar nga neni 11/1 pika a e ligjit nr 10192 date 03.09.2009 prandaj me qellim ruajtjen e tyre është e domosdoshme që për keto pasuri duhet të vendoset masa e sekuestros, bazuar në këtë ligj në kushtet

kur kërkesa gjendet e drejte dhe plotesohen kriteret e parashikuara ne kete ligj

Ne baze te nenit 12/2 te ligjit te sipercituar masa e sekuestros eshte e vlefshme per nje periudhe 6 mujore, duke u urdheruar sekretaria gjyqesore te kryeje veprimet e njoftimit sipas nenit 130 te K.Pr.Civile, sipas urdherimit te kesaj Gjykate.

Per ekzekutimin e ketij vendimi mbeshtetur ne nenin 14 te ligjit nr 10192 date 03.09.2009 urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor xxx, ndersa per administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet zj.D.B., e cila eshte administratore prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 212 e vijues te K.Pr.Civile nenet 3/1/ç; 3/4; 5; 7; 11/1/a, 12,14,15 e vijues te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

VENDOSI

-Pranimin e kërkeses se Prokurorise per Krime te Renda Tirane duke urdheruar:

”I- *Sekuestrimin e depozitës me gjendje xxx lekë në bankën “xxx” që i përkasin shtetases Xh.I.F. e cila maturohet me date xxx.*

-Sekuestrimin e depozitës bankare e gjendur ne xxx bank, në shumën xxx lekë në emër të shtetasit R.V.F. ndaj së cilës është vendosur sekuestro preventive.

II. *Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme si më poshtë vijon :*

- *Pasurisë së paluajtshme me nr.xxx,zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P., F., A. dhe V.Gj.*
- *Pasurisë së paluajtshme me nr.xxx, vol.4, fq.xxx me sipërfaqe xxx m2, ZK xxx, xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, blerë në shumën xxx lekë nga G.B.*
- *Pasurisë së paluajtshme me nr. xxx, zk xxx, vol.x, fq.x, me sipërfaqe xxx m2, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj.Gj.*
- *Pasurisë së paluajtshme me nr nr.xxx,zk xxx, vol.x, fq.xxx, are me*

sipërfaqe xxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, blerë në shumën xxx lekë nga Gj., P.,F., A. dhe V.Gj.

- ***Pasurisë së paluajtshme** me nr.xxx, zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m², në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx, xxx, përfituar me kontratë këmbimi.*
- ***Pasuria së paluajtshme** me nr.xxx, zk xxx, vol.x, fq.xxx, me sipërfaqe xxx m², në pronësi të Xh.F., regjistruar në xxx xxx, blerë në shumën xxx lek.*
- ***Pasurisë së paluajtshme** me nr.xxx, vol.x, fq.xx me sipërfaqe xxx m², xxx, në pronësi të R.V.F., regjistruar në xxx (për të cilën në datën xxx është ekzekutuar vendimi nr xxx datë xxx i Gjykatës së Shkallës së Parë, Rrethit Gjyqësor xxx duke u vendosur **Sekuestro Preventive**)*

-Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqësor, xxx.

-Per Administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet zj. D.B., e cila eshte administratore prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

-Urdherohet sekretaria Gjyqësore e kesaj Gjykate te dergoje menjehere **kopje te ketij vendimi ne Institucionet e siperme.**

-Kunder vendimit lejohet te behet ankim brenda afatit te parashikuar ne K.Pr.Civile ne Gjykatën e Apelit per Krimet e Renda Tirane.

U shpall ne Tirane sot me dt. 16.01.2014 ora 14.15.

SEKRETARE

GJYQTARE

Blerina SUKAJ

Nertina KOSOVA